



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Nr. 12738 / 5 Prot.

Tiranë, më 9.7.2026

**RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMEVE TRANSPORTIT RRUGOR**

**KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR” ose “Organizata”) bazohet në:

- a) ligjin nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” (në vijim “ligji”), në veçanti në nenin 20, pika 8, e në nenin 28, pika 3, të tij,
- b) në Kodin e Procedurave Administrative,
- c) në Vendimin nr. 395, datë 28.5.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësive përgjegjëse të sinjalizimit në autoritetet publike” (në vijim “VKM nr. 395/2026”), si dhe
- d) në urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI-ja, si autoritet kompetent.

Kjo rregullore zbatohet së bashku dhe në harmoni me Rregulloren për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit dhe të mbrojtjes së sinjalizuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, miratuar njëkohësisht, në zbatim të nenit 14, pika 3, të ligjit, e cila përcakton, ndër të tjera, krijimin dhe përbërjen e Njësive Përgjegjëse (NJP), të cilës i referohet kjo rregullore.



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati Bjorn, Tiranë,
1010; Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

- a) përcaktimi i rregullave për procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit nga Njësia Përgjegjëse (NJP) e DPSHTRR-së, në zbatim të ligjit;
- b) përcaktimi i mekanizmave për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të të dhënave personale gjatë procedurës së sinjalizimit dhe të hetimit administrativ, në zbatim të nenit 20, pika 8, të ligjit.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet nga NJP, për çdo sinjalizim të regjistruar sipas Rregullores për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit dhe të mbrojtjes së sinjalizuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, që i nënshtrohet hetimit administrativ.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të të dhënave personale zbatohen për identitetin dhe të dhënat e sinjalizuesit, të ndihmësit, të personave të lidhur me sinjalizuesin, si dhe të personave të përfshirë, gjatë çdo faze të trajtimit të sinjalizimit dhe të hetimit administrativ.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime, në përputhje me nenin 4, të ligjit dhe me Rregulloren për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit dhe të mbrojtjes së sinjalizuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

1. “Autoriteti kompetent” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), i caktuar, ndër të tjera, për të hetuar sinjalizimet e jashtme dhe për të dhënë udhëzime mbi procedurat e hetimit administrativ e të mbrojtjes së konfidencialitetit.
2. “DPSHTRR” ose “Organizata Publike” është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila gëzon statusin e një insitucioni publik dhe ushtron aktivitetin e saj në zbatim të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, përfshirë VKM-në nr. 343, datë 21.07.1999, për krijimin dhe funksionimin e institucionit.
3. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
4. “Informacion për shkeljet” është çdo lloj informacioni që përmban dyshime të arsyeshme dhe lidhet me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen, të përfutuara në një kontekst pune në DPSHTRR.
5. “Kontekst pune” është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme me DPSHTRR-në, përmes së cilës një person ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor.
6. “Ligji” është ligji nr. 96/2025, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.



7. “Njësia Përgjegjëse” ose “NJP” është organi i posaçëm, i krijuar dhe i organizuar sipas Rregullores për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit dhe të mbrojtjes së sinjalizuesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, i ngarkuar, ndër të tjera, me hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe me ruajtjen e konfidencialitetit, sipas kësaj rregulloreje.

8. “Person i përfshirë” ose “person i sinjalizuar” është çdo person fizik ose juridik që përmendet në sinjalizim ose në publikim si personi të cilit i atribuohet shkelja, ose që ka lidhje me autorin e shkeljes.

9. “Shkelje” është çdo veprim ose mosveprim i paligjshëm, që ka ndodhur ose ka gjasa të ndodhë, dhe për të cilin ka shkaqe të arsyeshme për ta konsideruar në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

10. “Sinjalizim” është raportimi ose sinjalizimi i informacionit, verbal ose me shkrim, nga sinjalizuesi te NJP ose tek ILDKPKI-ja, për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, nëpërmjet kanaleve të brendshme, të jashtme ose nëpërmjet publikimit.

11. “Sinjalizues” është çdo person fizik që, në një kontekst pune me DPSHTRR-në, sinjalizon ose publikon informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor.

Neni 5

Parimet e hetimit administrativ nga Njësia Përgjegjëse

Në zbatim të ligjit, NJP bazohet në parimet dhe ushtron kompetencat:

- a) me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizuesit;
- b) në mënyrë të pavarur, jashtë çdo influence politike dhe çdo influence tjetër të padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
- c) duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
- ç) duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat e lidhura me sinjalizimin, nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera që synojnë asgjësimin e tyre;
- d) duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- dh) duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit;
- e) duke zbatuar mekanizma të efektshëm dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitime të sinjalizuesit;
- ë) duke përfunduar procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU II

PROCEDURAT E VEPRIMIT

Neni 6

Kryerja e veprimeve procedurale

1. Veprimet procedurale të NJP-së kryhen në përputhje me ligjin, dhe në rast të mungesës së parashikimeve nga ligji, sipas Kodit të Procedurave Administrative.



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati Bjorn, Tiranë,
1010; Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat NJP cakton afate, përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

Neni 7

Mosfillimi i hetimit administrativ

1. NJP ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ, kur:
 - a) sinjalizimi, me përjashtim të rasteve të sinjalizimit anonim, nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar, dhe sinjalizuesi nuk i korrigjon këto të meta brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b) sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit;
 - c) nga përmbajtja e sinjalizimit, si dhe nga verifikimi paraprak, del haptazi se nuk ka elementë të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale;
 - ç) sinjalizimi është i përsëritur dhe nuk përmban informacione të reja, përveç rasteve kur paraqiten rrethana të reja ose prova të rëndësishme që justifikojnë rihapjen e çështjes.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të NJP-së, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR-së.
3. Vendimi i arsyetuar për mosfillimin i përcillet sinjalizuesit, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e tij.

Neni 8

Kalimi i hetimit pranë ILDKPKI-së

1. Hetimi administrativ kalon për kompetencë pranë ILDKPKI-së, si mekanizëm i jashtëm sinjalizimi, kur:
 - a) sinjalizuesi vlerëson se shkelja nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda DPSHTRR-së;
 - b) ekziston rrezik për veprime hakmarrëse ndaj sinjalizuesit, ose ndaj personave të lidhur me të;
 - c) sinjalizuesi ka paraqitur fillimisht sinjalizimin pranë NJP-së dhe nuk është informuar për ecurinë ose trajtimin e tij, brenda afateve të parashikuara në Rregulloren për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit;
 - ç) NJP nuk fillon hetimin administrativ ose e përfundon atë në kundërshtim me nenin 12 e me nenin 16 të kësaj rregulloreje;
 - d) ekziston dyshim i arsyeshëm se punonjësi i NJP-së që pret sinjalizimin, ose persona të lidhur me të, janë të përfshirë ose kanë interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pasuror ose personal, në veprimin e kundërligjshëm;
 - dh) ekzistojnë arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin ose paanshmërinë e NJP-së në shqyrtimin e sinjalizimit;
 - e) provat e sinjalizuara mund të fshihen ose të shkatërrohen nga DPSHTRR-ja.
2. Sinjalizuesi mund t'i drejtohet ILDKPKI-së drejtpërdrejt, pa qenë e nevojshme paraqitja paraprake e sinjalizimit pranë NJP-së, sipas kushteve të parashikuara në Rregulloren për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit.
3. Në rastet e pikës 1 të këtij neni, çdo hetim i NJP-së, nëse ka filluar, ndërpritet, dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja. Nëse ILDKPKI-ja konstaton se nuk



vërtetohen kushtet e parashikuara në pikën 1, me vendim të arsyetuar, ia dërgon sinjalizimin NJP-së për nisjen ose vijimin e hetimit administrativ.

KREU III

HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 9

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen nga NJP në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik, të krijuar për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. NJP nuk mund të refuzojë, për asnjë shkak, regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 10

Verifikimi paraprak

1. NJP kryen verifikim paraprak të sinjalizimit të regjistruar, për të verifikuar nëse, nga përmbajtja e tij, ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që informacioni i sinjalizuar përmban elemente të një kundërvajtjeje administrative ose të një vepre penale.
2. NJP, në kuadër të verifikimit paraprak, vlerëson nevojën për propozimin e masave të përkohshme për mbrojtjen e sinjalizuesit, nëse krijohet bindja se ai mund të jetë objekt i veprimeve hakmarrëse, dhe e informon për të drejtën e tij për të paraqitur kërkesë për mbrojtje pranë ILDKPKI-së.

Neni 11

Trajtimi me përparësi i sinjalizimit

1. NJP trajton sinjalizimet duke marrë për bazë radhën sipas parimit të kohës së regjistrimit.
2. Në rastet kur ka për trajtim një numër të lartë sinjalizimesh, me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, i jepet përparësi sinjalizimeve që lidhen me çështje me interes të lartë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, rastet:
 - a) që kanë të bëjnë me rreziqe aktuale ose që ndikojnë në shëndetin publik, sigurinë ose të drejtat dhe liritë themelore;
 - b) që përfshijnë funksionarë të lartë të DPSHTRR-së;
 - c) që lidhen me interesa financiare të DPSHTRR-së;
 - ç) për të cilat kanalet e brendshme të raportimit nuk kanë funksionuar ose janë penguar.

Neni 12

Procedura e hetimit administrativ

1. NJP heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligj. Për sa nuk parashikohet ndryshe në ligj, NJP zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. NJP ka të drejtë të kërkojë informacione e dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata, të pyesë persona me dijeni për rrethanat e çështjes, ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.



3. Në hetimin administrativ marrin pjesë sinjalizuesi dhe çdo person i tretë, kur dyshohet se zotëron dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë personin e përfshirë, kur kjo vlerësohet e nevojshme nga NJP.
4. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, përfshirë:
- a) të drejtën për të dhënë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b) të drejtën për t'u njohur me dosjen e hetimit, me përjashtim të të dhënave të sinjalizuesit dhe të çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e tij, të cilat paraqiten në mënyrë të anonimizuar;
 - c) të drejtën për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e parashtruara.
5. NJP njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kryerjes së veprimit. Pavarësisht këtij afati, NJP është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve çdo kërkesë me shkrim, paraqitur nga sinjalizuesi, lidhur me ecurinë e çështjes.
6. NJP merr masa të menjëhershme, për aq sa është e mundur, duke njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga shkelja e sinjalizuar.

Neni 13

Provat në hetimin administrativ

1. NJP dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin merren ose pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit për dhënien e dokumentacionit shkresor ose të çdo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor, në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e NJP-së kanë të drejtë të këqyrin sende, vende ose dokumentacion, me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve a të pasojave të veprimtarisë së dyshuar si të kundërligjshme. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete fotografike a filmike, ose në çdo mënyrë tjetër të ligjshme.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e NJP-së vlerësojnë se ekzistojnë rrethana për manipulimin ose asgjësimin e dokumenteve, ata bllokojnë dokumentacionin ose mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës ose personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente, gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Mbahet procesverbal, i nënshkruar nga punonjësit e NJP-së dhe nga zyrtarët përgjegjës ose personat e tjerë. Zhblokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së.
4. Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësit e NJP-së zbatojnë, për aq sa është e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i nënshkruar nga punonjësit e NJP-së dhe nga drejtuesi i strukturës së verifikuar. Në rast mosmarrëveshjeje për përmbajtjen e aktit, ky i fundit ka të drejtë të bëjë vërejtje dhe të paraqesë kundërshtime me shkrim, kopje e të cilave i bashkëlidhet aktit.



Neni 14

Pjesëmarrja e sinjalizuesit gjatë hetimit administrativ

1. Gjatë hetimit administrativ, sinjalizuesi mund të thirret për t'u paraqitur nga NJP, ose të paraqitet me kërkesë të tij, për të dhënë shpjegime ose akte provuese shtesë që janë të nevojshme për hetimin.
2. Kur sinjalizimi është anonim, paraqitja e shpjegimeve ose e akteve provuese kryhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik që përmbushin garancitë për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit.

Neni 15

Pjesëmarrja e të sinjalizuarit dhe e personave të përfshirë gjatë hetimit administrativ

1. Personi i sinjalizuar ose personat e përfshirë marrin pjesë në procesin e hetimit administrativ, kur pjesëmarrja e tyre çmohet e nevojshme nga NJP.
2. Në rastet kur NJP vlerëson se thirrja e personit të sinjalizuar ose e personave të përfshirë mund të përbëjë rrezik për fshehjen, prishjen ose asgjësimin e provave, njoftimi mund të kryhet pas sigurimit të provave, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Përfundimi i hetimit administrativ

1. NJP përfundon hetimin administrativ, kur:
 - a) gjatë hetimit konstatohet se sinjalizimi është i bazuar, duke referuar çështjen menjëherë te ILDKPKI-ja, kur përmban elemente të kundërvajtjes administrative, ose te organet e prokurorisë apo të Policisë së Shtetit, kur dyshohet vepër penale;
 - b) sinjalizimi rezulton i pabazuar në fakte e të dhëna;
 - c) sinjalizuesi ka paraqitur me dashje informacion të rremë ose të pasaktë.
2. Referimi i çështjes te organi kompetent, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, bëhet me të dhëna të anonimizuara ose të depersonalizuara, në lidhje me identitetin e sinjalizuesit.
3. Vendimi për përfundimin e hetimit administrativ miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR-së, me propozim të NJP-së, dhe arsyetohet për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe për masat e marra në lidhje me sinjalizimin.
4. Vendimi i arsyetuar i përcillet sinjalizuesit, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e tij.
5. Kundër vendimit për përfundimin e hetimit administrativ, sinjalizuesi mund të bëjë ankim pranë ILDKPKI-së, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.



Neni 17

Afati për vendimmarrjen

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga NJP përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e fillimit të hetimit, përveç se kur, nga rrethanat, kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, duke përcaktuar edhe afatin e ri kohor të shtyrjes, në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

KREU IV

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 18

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Identiteti i personit të përfshirë, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me të, ruhet dhe mbrohet në kushte konfidencialiteti nga NJP.
3. NJP ruan, në çdo kohë, në mënyrë konfidenciale, informacionin e lidhur me sinjalizimin, nuk e përhap ose transmeton tek persona të tretë, dhe nuk e përdor për qëllime të tjera, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e ligjit.
4. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit dhe i të dhënave të përpunuara, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kryhet edhe pa pëlqimin e tij, vetëm në rastet kur është i domosdoshëm, në mënyrë të arsyetuar e proporcionale, për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor.
5. NJP njofton me shkrim sinjalizuesin mbi arsyet e justifikuara për zbulimin e të dhënave konfidenciale, si dhe masat e marra për të kufizuar sa më shumë rrezikun e ekspozimit të panevojshëm, përveç rasteve kur një informim i tillë do të rrezikonte hetimin ose procedimin gjyqësor.
6. Shkelja e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit nga punonjësi i NJP-së përbën shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe sjell përgjegjësinë përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19

Standardet e konfidencialitetit në ushtrimin e të drejtës për njohjen me dosjen

1. Çdo e dhënë e dosjes hetimore që mund të çojë në identifikimin e sinjalizuesit, duke përfshirë të dhënat e sinjalizuesit, paraqitet në mënyrë të anonimizuar për palët e treta.
2. Vendimmarrjet që përmbajnë të dhëna për procedurën hetimore dhe gjetjet mbi sinjalizimin vihen në dispozicion të palëve të treta në mënyrë të anonimizuar.

Neni 20

Mbrojtja e të dhënave personale



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë,
1010; Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al; www.dpshttr.gov.al

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllimet e ligjit. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve e procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Nëse të dhëna personale që nuk konsiderohen të nevojshme për hetimin mbledhen rastësisht, ato fshihen menjëherë dhe nuk përfshihen në hetimin administrativ.
3. Kur, gjatë zbatimit të ligjit dhe të kësaj rregulloreje, konstatohen shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 21

Ruajtja e të dhënave, administrimi i dokumentacionit dhe krijimi i kushteve

1. NJP siguron gjurmueshmërinë e të dhënave e të informacionit, si dhe ruan dokumentacionin e krijuar në formë shkresore ose elektronike, duke garantuar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit dhe të personave të përfshirë.
2. Dokumentacioni origjinal ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur procedura ligjore përkatëse ende nuk ka përfunduar.
3. Strukturat përkatëse në DPSHTRR, marrin të gjitha masat për të krijuar dhe siguruar kushtet e nevojshme për NJP, për ruajtjen e dokumentacionit me qëllim garantimin e konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit dhe të personave të përfshirë, si dhe mjetet e nevojshme për realizimin e detyrave sipas legjislacionit në fuqi dhe në këtë rregullore.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Drejtori i Përgjithshëm i DPSHTRR-së.

Çdo akt i brendshëm rregullativ i cili bie ndesh me këtë rregullore, shfuqizohet.

Miratur me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 996, datë 9.07.2026



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR**

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati Bjorn, Tiranë,
1010; Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175
e-mail: dpshtrr@dpshtrr.gov.al; www.dpshtrr.gov.al